REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 444/25 Dt. 23.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 24 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MENAXHIMIN ME PLATFORMËN E KONSULTIMEVE PUBLIK NË KOMUNËN E PRIZRENIT

1. Haziz Krasniqi- zyrtar i Lartë për Raportim dhe Informim në Komunën e Prizrenit, caktohet si zyrtar përgjegjës për menaxhimin me platformën e Konsultimeve Publike në Komunën e Prizrenit.

2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtarit të caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

3. Me këtë Vendim shfuqizohet vendimi nr. 01/060-0086247/22, i datës 10.06.2022.

4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

5. Obligohet zyrtari i lartcekur dhe Drejtoritë/Njësit përkatëse relevante, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Zyrës për Informim,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.